



Pranuar / Dorezuar Prilimeno/Prodato Received / Delivery	21.02.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	913/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. nr. 44/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi - Bajraktari, kryetare Eshref Shabani, dhe Jeton Koca, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A. nr. 2685/19, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 546/2019, të datës 16.09.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Ministria e Integritetit Evropianë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.02.2022, mori këtë

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A. nr.546/2019 e datës 16.09.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr. 1569-1-2019 i datës 16.08.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Integritetit Evropianë .
- III. ANULOHET Vërejtja me shkrim me numër protokolli 1259-1-2019 e datës 05.07.2019, e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritetit Evropianë për ankuesin.
- IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritetit Evropianë dhe Menaxheri i Personelit, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke ia larguar nga dosja personale e ankuesit „Vërejtjen me Shkrim“ të dates 05.07.2019 të shqiptuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ndaj ankuesit [REDACTED] punësuar në Ministrinë e Integritimeve Evropiane, në pozitën „Drejtor i Departamentit për Kriteria Politike“, me datë 05.07.2019 Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë respektivisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimeve Evropiane i shqipton masën disiplinore „Vërejtje me shkrim“ me arsyetimin se ankuesi nuk ka realizuar obligimet e tij në kërkesat për të zbatuar dhe iniciuar procedurën për rekrutim të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Ankuesi i pakënaqur me shqiptimin e masës disiplinore „Vërejtje me shkrim“ me numër protokollit 1259-1-2019 të datës 05.07.2019 nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, respektivisht nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimeve Evropiane, me datë 19.07.2019 parashtron ankesë me numër protokollit 1360-1-2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Integritimeve Evropiane.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Integritimeve Evropiane, me datë 16.08.2019 nxjerre Vendim me numër 1569-1-2019, me të cilin e vendim e refuzon si të pabazuar ankesën e datës 19.07.2019 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 1569-1-2019 të datës 16.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Integritimeve Evropiane, me 13.09.2019 përmes emalit zyrtar parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila regjistrohet me date 16.09.2019 me numër protokollit 4324/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me date 19.09.2019 kërkesën për përgjigje në ankese e ka proceduar tek Ministria e Integritimeve Evropiane, ndërsa me datë 24.09.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen nga Ministria e Integritimeve Evropiane, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 16.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.01.2022, ka nxjerr Aktgjykim me numër A. nr. 2685/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.10.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 13.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër A. nr.546/2019, të datës 16.09.2019, të parashtruar nga ankuesi Valon Gashi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi me numër A.nr.2685/19, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Emaili i datës

28.12.2019; Emaili i datës 03.07.2019; Vendimi i datës 10.10.2012; Emaili i datës 04.07.2019; sistematizimi i bursistëve nga skema e profesionalistëve të rinj; Njoftimi i datës 06.08.2019, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm; Emaili i datës 27.08.2019; Emaili i datës 09.09.2019; Emaili i datës 13.09.2019; Vërejtje me shkrim e datës 05.07.2019; Vendimi i datës 16.08.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 26.11.2012; Emaili i datës 20.12.2018; Emaili i datës 03.06.2019; Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Njoftimi i datës 16.10.2019, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 24.09.2019, me numër protokoll 4498/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e bazuar, *për shkak të shkeljeve procedurale dhe ligjore të bëra nga organi i punësimit.*

Kolegji për shqyrtimin e anekseve ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian, me datë 05.07.2019 i ka shqiptuar masën disiplinore „Vërejtje me Shkrim“ ankuesit _____ me pretendimin se ankuesi nuk ka realizuar obligimet e tij në kërkesat për të zbatuar dhe iniciuar procedurën për rekrutim të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm, gjegjësisht me veprimin e tij ankuesi ka kryer shkelje të detyrave të punës sipas nenit 10 të Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil dhe nenit 7 Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil është përcaktuar procedura e paraqitjes dhe shqyrtimit të rasteve të paraqitura për shkeljet e dyshuara të nëpunësit dhe përgjegjësia e udhëheqësit të drejtpërdrejtë ose udhëheqësit më të lartë administrativ që të vendos nëse shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë -serioze

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian, me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore „Vërejtje me Shkrim“ me numër protokoll 1259-1-2019 të datës 05.07.2019 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 paragrafit 2 dhe 5 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ku përcaktohen kompetencat e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë apo Udhëheqësit më të lartë administrativ si në vijim: 2. *“Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose udhëheqësi më i lartë administrativ identifikon detajet e shkeljes dhe vendos se shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë-serioze”* si dhe 5. *“Udhëheqësi i drejtpërdrejtë fillimisht do të kontaktojë me shkelësin, dhe me çdonjërin që mund të ofrojë dëshmi në lidhje me rastin”*, sepse në rastin konkret në bazë të provave të lëndës nuk kemi asnjë dëshmi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit të ketë ftuar ankuesin për të kontaktuar apo biseduar lidhur me shkeljet e supozuara ashtu siç përcaktohet me nenin 11 paragrafin 2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se masa disiplinore „vërejtje me shkrim“ me numër protokoll 1259-1-2019 e datës 05.07.2019, e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku thuhet se *“Për shkeljet e lehta të përcaktuara më nenin 5 të kësaj*

Rregulloreje, mund të shqiptohen këto masa disiplinore: 1.2), vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë shqiptohet në proporcion me pasojat e shkaktuara dhe vendoset në dosjen personale të nëpunësit civil", sepse në rastin konkret udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka dështuar që të përcaktojë natyrën e shkeljes, nuk ka identifikuar detajet e shkeljes konkretisht nuk ka përcaktuar njëra prej shtatë (7) shkeljeve të lehta të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku për këto shkelje shqiptohet masa disiplinore „vërejtje me shkrim“, gjegjësisht mbikëqyrësi nuk ka vendos nëse shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë-serioze, si dhe procedurat dhe afatet për shqiptimin e masave disiplinore, pasi që në këtë vërejtje nuk ka asnjë të dhënë se për cilën shkelje bëhet fjalë, për kohën kur është kryer shkelja e pretenduar si dhe me cilën dispozitë ligjore është përcaktuar si shkelje, andaj Kolegji konstaton se se masa e shqiptuar „Verjetje me shkrim“ nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk është shqiptuar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, konkretisht nuk janë respektuar dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil lidhur me procedurën e paraqitjes dhe shqyrtimit të rasteve të paraqitura për shkeljet e dyshuara të nëpunësit si dhe lidhur me përgjegjësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë ose udhëheqësit më të lartë administrativ.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që masa disiplinore „vërejtje me shkrim“ me numër protokolli 1259-1-2019 e datës 05.07.2019 e shqiptuar ndaj ankuesit është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar poashtu se Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Integriteteve Evropiane, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 1569-1-2019 të datës 16.08.2019 ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin N. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike dhe nuk ka arritur që të eliminoj shkeljet e bëra me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore gjegjësisht shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit.

Duke marr parasysh shkeljet e lartëcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka vendosur për shfuqizimin e Vendimit me numër 1569-1-2019 të datës 16.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Integriteteve Evropiane si dhe të anulimit të Vërejtjes me shkrim me numër protokolli 1259-1-2019 të datës 05.07.2019 të shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integriteteve Evropiane, duke e obliguar Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi dhe heqjen e vërejtjes me shkrim me numër protokolli 1259-1-2019 të datës 05.07.2019, nga dosja personale e ankuesit

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A.nr. 44/2022

Rushit KAJTAZI

[Signature]
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Integritimit Evropian;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Integritimit Evropian;
- Arkivit të KPMSHCK-së

